

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

VIZITË ZYRTARE NË BRITANI

MANJA MERR PJESË NË KONFERENCËN E MINISTRAVE TË DREJTËSISË NË BRITANI



LEXO PËR MË SHUMË

Ministri Manja merr pjesë në Konferencën e Ministrave të Drejtësisë për të riafirmuar mbështetjen e Shqipërisë, qeverisë shqiptare dhe popullit shqiptar në hetimin e krimeve të luftës mbi popullsinë civile në Ukrainë në kuadrin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

TAKIM DYPALËSH ME MINISTREN E REPUBLIKËS FEDERALE TË AUSTRISË ALMA ZADIĆ



Mbahet takimi dypalësh me Ministren e Republikës Federale të Austrisë Alma Zadić. Në këtë takim u evidentua bashkëpunimi i shkëlqyer në fushën e drejtësisë dhe sundimit të ligjit në mes dy vendeve dhe dy ministrive. Ministri Manja, në emër të qeverisë shqiptare e falenderoi Ministren Zadić për mbështetjen që Austria ka dhënë në kuadrin e BE dhe nëpërmjet Agjencisë Austriake për Zhvillim për zbatimin e Reformës në Drejtësi, procesin e vetingut, ndihmës juridike falas, ndërmjetësimit dhe në edukimin ligjor të të rinjve.

LEXO PËR MË SHUMË

MANJA TAKON RT HON DOMINIC RAAB, ZËVENDËS KRYEMINISTËR, SEKRETAR I SHTETIT PËR DREJTËSINË DHE LORDI KANCELAR PËR MBRETËRINË E BASHKUAR



Manja takon RT Hon Dominic Raab, Zëvendës Kryeministër, Sekretar i Shtetit për Drejtësinë dhe Lordi Kancelar për Mbretërinë e Bashkuar. Në këtë takim u bisedua për të çuar përpara bashkëpunimin në fushën e drejtësisë, luftës kundër krimit të organizuar dhe për zbatimin e marrëveshjes dypalëshe në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale, e cila është në fuqi që prej vitit 2021.



MANJA TAKON HOMOLOGEN E TIJ, MINISTREN E DREJTËSISË SË HOLLANDËS DILAN YEŞILGÖZ-ZEGERIUS



Një takim me Ministrën e Drejtësisë së Hollandës Dilan Yeşilgöz-Zegerius, njëkohësisht mikpritëse e konferencës së bashku me Ministrin e Drejtësisë së Britanisë së Madhe Domenik Raab. Kolegët ndanë mendime dhe qëndrime të përbashkëta për bashkëpunimin në fushën e drejtësisë, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në nivel ndërkombëtar.

LEXO PËR MË SHUMË

MANJA-ZADIC, NËNSHKRUAJNË DEKLARATËN E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E FORCIMIT TË SUNDIMIT TË LIGJIT



Ministri Manja bashkë me homologen dhe miken e Shqipërisë, Ministren e Drejtësisë në Republikën Federale të Austrisë Alma Zadić nënshkruan deklaratën e bashkëpunimit në fushën e forcimit të sundimit të ligjit. Si mike e vjetër dhe e çmuar e Shqipërisë,

Manja i shprehu mirënjohjen Republikës Federale të Austrisë për mbështetjen pa kushte për forcimin e shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit, si garanci për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

LEXO PËR MË SHUMË

TRYEZË DISKUTIMI NË MBËSHTETJE TË AGJENCISË AUSTRIAKE PËR ZHVILLIM



Në Ministrinë e Drejtësisë mikpritet Presidenti Federal i Austrisë Sh.T.Z Alexander Van der Bellen, së bashku me Zonjën e Parë dhe delegacionin që e shoqëronte, në një tryezë të shkëlqyer pune ku u prezantuan të gjitha projektet që mbështeten nga Agjencia Austriake për Zhvillim në fushën e drejtësisë dhe sundimit të ligjit për zbatimin e plotë të reformës në drejtësi.

LEXO PËR MË SHUMË

PRISHTINË, MBLEDHJE E GRUPIT TEKNIK TË DY MINISTRIVE SHQIPËRI-KOSOVË



Ministri Manja bashkë me homologen e tij Albulena Haxhiu i dhanë një dorë më shumë mbledhjes së grupit teknik të dy ministrive tona, për të jetësuar marrëveshje të tjera në fushën e profesioneve të lira. Këtij takimi iu bashkuan dhe drejtuesit e odave dhe dhomave të avokatisë, noterisë dhe ndërmjetësimit. Vullneti politik i dy qeverive është i njohur botërisht, përkushtimi i dy ministrive tona është në nivelin maksimal, shprehu Manja. Manja Theksoi që ekspertët e të dy institucioneve të gjejnë rrugët për të shkuar tek qëllimi i përbashkët: njohja reciproke e licencave të profesioneve të lira, me qëllim që qytetarët tanë të marrin shërbime ligjore cilësore dhe në kohë të shpejtë. Duke qënë se Shqipëria është në procesin e negociatave, u dakordësua që bashkëpunimi mes dy ministrive të shtrihet edhe në kuadrin të përafimit të legjislacionit me BE.

LEXO PËR MË SHUMË

MINISTRI MANJA CERTIFIKON GRUPIN E PARË TË ZËVENDËSNOTERËVE



LEXO PËR MË SHUMË

Certifkohet grupi i parë të Zëvendësnoterëve, të cilët kryen betimin solemn për të kryer detyrat në përputhje me ligjin, duke i qendruar besnik Kushtetutës, për të ruajtur sekretin profesional dhe për t'u udhëhequr nga parimet e profesionalizmit, paanësisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Zbatimi me korrektësi i legjislacionit modern e bashkëkohor dhe digjitalizimi i proceseve noteriale është rruga e duhur për t'u distancuar nga individë që s'kanë asnjë lidhje me këtë profesion fisnik dhe për të ofruar shërbime cilësore për qytetarët. Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterëve po punojnë ngushtësisht për t'i dhënë frymë dhe fytyrë të re notariatit në Shqipëri.

FLOTA E POLICISË SË BURGJEVE SHTOHET ME 12 MAKINA TË REJA



LEXO PËR MË SHUMË

Flotë së Policisë së Burgjeve iu shtuan dhe 12 makina të reja në mbështetje të sigurisë dhe punës sfiduese të kësaj strukture, dhuratë nga Ambasada Britanike! Në këtë aktivitet Ministri Manja, bashkë me Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve z. Admir Abrija, i shprehën mirënjohjen e tyre Ambasadorit Britanik në Shqipëri, Z Alastair King-Smith. Me shtimin e flotës së re në Policinë e Burgjeve është fokus rritja e standardit të shërbimeve dhe performancës